



STUDIM STATISTIKOR MBI IDENTITËTIN IDEOLOGJIK NË SHQIPËRI

Bashkim Shehu
Dr. Eduard Zaloshnja



Studim statistikor mbi identitetin ideologjik në Shqipëri

Autorë: Bashkim Shehu dhe Eduard Zaloshnja, PhD

*Mbështetur nga Fondacioni Konrad Adenauer (KAS), Zyra për Shqipërinë
Maj 2026*

HYRJE

Me krijimin e sistemit shumëpartiak në Shqipëri nga fillimi i viteve 1990, Partia Socialiste, trashëgimtare e PPSH (partia komuniste), e identifikoi veten si e majtë. Dhe, ngjashmërisht me partitë e tjera komuniste të Europës Lindore, përvetësoi simbologjinë e partive socialiste apo socialdemokrate të Perëndimit. Në të njëjtën kohë, dhe pjesërisht si efekt reagimi, Partia Demokratike dhe të tjera parti të reja në Shqipëri e identifikuan veten si të djathta.

I njëjti dallim apo e njëjta ndarje “e djathtë - e majtë”, si terma të identitetit politik, pa kurrfarë precedenti në historinë e vendit – madje mund të themi se, në këtë aspekt, përbën rastin më të pastër, më ex nihilo të këtij fenomeni në krejt Europën Lindore, – gjen pasqyrim edhe në vetidentifikimin e qytetarëve shqiptarë në anësitë e tyre partiake, si dhe në ligjërimin publik përgjithësisht.

Ky studim statistikor synon të analizojë në thellësi identiteti ideologjik simbolik i lartpërmendur, për të parë se deri në çfarë mase është në përputhje me substancën reale të ndarjes “e djathtë - e majtë” nga pikëpamja e projekteve dhe vlerave politike. Si kriter dallues, do t'i referohemi spektrit politik të Europës Perëndimore, që është hapësira klasike e kësaj mënyre identifikimi në politikë.

Për këtë studim, është përdorur një kampion i shtresëzuar prej 1,119 të anketuarish të moshave 18 vjeç e sipër me banim në Shqipëri. Në shtresën e parë, intervistat u shpërndanë përpjesëtimisht mes 12 qarqeve të vendit, bazuar në popullsinë e tyre në moshë madhore. Në shtresën e dytë, ato u shpërndanë përpjesëtimisht në zonat urbane/periferike dhe rurale brenda çdo qarku, për të pasqyruar shpërndarjen gjeografike. Në mënyrë të ngjashme u caktuan edhe kuotat e moshës e të gjinisë për çdonjërin prej shtresave. Së fundi, pikat e anketimit u përzgjedhën rastësisht nga harta digjitale e Shqipërisë për intervistat, në përputhje me skemën e mësipërme të kampionimit. Qëllimi i kësaj qasjeje të shtresëzuar ishte përfaqësimi sa më i saktë gjeografik, demografik dhe politik i popullsisë në moshë madhore, duke siguruar një marzh gabimi statistikor deri në +/- 2.9% në rang vendi. Ky kampionim i rastësishëm e i shtresëzuar siguron që gjithë banorët 18 vjeç e sipër të kenë probabilitete të barabarta përzgjedhjeje për anketim.

Rezultatet kryesore

- Nga pikëpamja ideologjike, 41% e të anketuarve në vrojtimin tonë statistikor e konsiderojnë veten të majtë, 31.3% të djathtë dhe 24.2% të qendrës (3.5% u përgjigjën “Nuk e di”).
- Shumica dërrmuese e të anketuarve (82%-94%) përkrahin politika historikisht të majta europianoperëndimore për arsimin, shëndetësinë, tatimet, ndihmën sociale dhe ndërhyrjen e shtetit në ekonominë e vendit.

- Edhe ndër të anketuarit e vetidentifikuar si të djathtë ideologjikisht, shumica dërrmuese (81%-95%) përkrahin politika historikisht të majta europianoperëndimore për këto fusha.
- Pothuaj gjysma e të anketuarve (49.3%) e konsiderojnë veten tradicionalë në jetën familjare dhe vetëm 17.8% e konsiderojnë veten liberalë (32.7% e konsiderojnë veten diku në mes). Të vetidentifikuarit si të djathtë janë më tradicionalë se të vetidentifikuarit si të majtë (58.4% kundrejt 48.6%).

Konkluzionet kryesore

- Vetidentifikimi ideologjik i qytetarëve shqiptarë përputhet në një masë shumë të madhe me vetidentifikimet ideologjike përkatëse të dy partive kryesore të vendit: shumica dërrmuese e atyre që e konsiderojnë veten të majtë kanë votuar për PS-në në zgjedhjet e fundit dhe shumica dërrmuese e atyre që e konsiderojnë veten të djathtë kanë votuar për PD-në.
- Ndër qytetarët shqiptarë, pavarësisht nga vetidentifikimi i tyre ideologjik, ekziston një konsens shumë i gjerë në favor të politikave sociale që në Europën Perëndimore konsiderohen të majta.
- Qytetarët me të ardhura të larta familjare janë më të prirur të votojnë për PS-në, të vetidentifikuar si të majtë, sesa për PD-në. Kjo shpjegohet pjesërisht edhe me faktin se, ndër punonjësit e sektorit shtetëror, numri i atyre që kanë votuar në zgjedhjet e fundit për partinë në pushtet, PS-në, është përpjesëtimisht më i madh se numri i atyre që kanë votuar për PD-në.
- Në vetidentifikimin ideologjik dhe në votimin e qytetarëve me banim në Shqipëri, faktori që ndikon në mënyrë të theksuar më shumë se të gjithë është ai i statusit politik të familjes gjatë periudhës së diktaturës komuniste: shumica dërrmuese e qytetarëve me prejardhje nga familje komuniste e identifikojnë veten si të majtë dhe votojnë për PS-në, ndërsa pjesa më e madhe e qytetarëve me prejardhje nga familje të përndjekura ose të përzierja nga pikëpamja e statusit politik nën diktaturën komuniste e identifikojnë veten si të djathtë dhe votojnë për PD-në.

REZULTATE TË DETAJUARA

Në tri tabelat e mëposhtme, të anketuarit janë pyetur në lidhje me disa nga objektet kryesore të politikave sociale të shtetit, që përbëjnë tregues të rëndësishëm të ndarjes ideologjike “e djathtë - e majtë” në kuptimin klasik të fjalës: përkatësisht në lidhje me shëndetësinë, me arsimin dhe me ndihmën financiare për shtresat e varfra. Është e vërtetë se, në Europën Perëndimore, ka ndodhur prej kohësh një konvergim midis së majtës dhe së djathtës për këta tregues të mbështetjeve sociale të financuara nga shteti, ashtu sikurse edhe për të tjerë tregues që do të trajtohen më poshtë. Megjithatë, prirja për më shumë shpenzime të buxhetit shtetëror në politika sociale shihet si e majtë në Perëndim. Nga përgjigjet e tabelave 1, 2 dhe 3, mund të shihet se në shoqërinë shqiptare ka një konsens shumë të gjerë në favor të politikave sociale ekspansive.

1. Si duhet të jetë shërbimi shëndetësor?	%
1. Falas, mbuluar nga shteti për të gjithë pa dallim	83.3
2. Falas vetëm për ata me siguracion	14.2
3. Duhet favorizuar shërbimi privat, me pagesë	2.4

4. (Nuk e di)	0.1
<hr/>	
2. Si duhet të jetë arsimi?	%
<hr/>	
1. Falas, mbuluar nga shteti	84.0
2. Duhet favorizuar arsimi privat, me pagesë	1.9
3. Sistem i përzier, me pagesë më të ulët se ai thjesht privat	13.9
4. (Nuk e di)	0.3
<hr/>	
3. Shtresat e varfra duhet të përkrahen kryesisht:	%
<hr/>	
1. Nga shteti	93.7
2. Nga shoqatat bamirëse	3.7
3. Nga rrethi familjar/shoqëror	2.4
4. (Nuk e di)	0.2
<hr/>	

Ndonëse përgjithësisht në Europën Perëndimore strehimi (objekti i tabelës së mëposhtme) konsiderohet si e drejtë e qytetarit, në rastin më të mirë kjo gjen shprehje të ndihma nga shteti ose nga administrata publike për t'ua bërë të mundshëm strehimin atyre që janë më nevojtarë. Edhe në shoqërinë shqiptare, nuk shihet si një e drejtë që duhet garantuar dhe, rrjedhimisht, qëndrimi është i ndryshëm nga ai i konsensit që vërejmë në aspektet për të cilat bëhet fjalë në tri tabelat e mësipërme. Kështu, në lidhje me strehimin, nga tabela e mëposhtme shohim se qytetarët shqiptarë anojnë më shumë nga ideja se strehimi nuk është një e drejtë e qytetarit, e cila, si e tillë, duhet garantuar nga shteti, po është diçka që duhet të sigurohet në treg nga secili privatist. Ndërkaq, edhe përqindja e atyre që shikojnë strehimin si një të drejtë është mjaft e lartë.

4. A mendoni se strehimi duhet të garantohet financiarisht nga shteti?	%
<hr/>	
1. Po	40.3
2. Jo, secili ta sigurojë vetë	57.0
3. (Nuk e di)	2.7
<hr/>	

Në Europën Perëndimore, përqindja e lartë e tatimeve lidhet qoftë realisht, qoftë simbolikisht me të majtën, sikurse ulja e taksave lidhet me të djathtën. Nga ana tjetër, tatimi është progresiv, pavarësisht nga identiteti ideologjik i forcave qeverisëse. Në Shqipëri, PD-ja aplikoi tatimin e sheshtë gjatë qeverisjes së viteve 2005-2013 dhe vazhdon ta ketë në program. Por mund të themi se edhe PS-ja, pasi u kthye në pushtet, ruajti një tatim gati të sheshtë: pretendon se ka rikthyer tatimin progresiv, por në të vërtetë janë po ato përqindje që aplikoi qeveria e PD-së më 1992, në një kohë kur ekonomia e tregut sapo kishte filluar dhe biznesi ende ishte në pelena. Ndërsa në vendet e Europës Perëndimore

kuotat e sipërme të tatimit progresiv janë mbi 40% dhe arrijnë deri në 60%, në Shqipëri arrijnë vetëm në 23%. Nga tabela e mëposhtme del se, ndryshe nga politika tatimore e partive kryesore në Shqipëri, ndër qytetarët ekziston një konsens shumë i gjerë për tatimin progresiv, pra në favor të rishpërndarjes së të ardhurave.

5. Tatimi mbi të ardhurat duhet të jetë:	%
1. Me përqindje të njëjtë për të gjithë	17.3
2. Me përqindje më të larta për ata me të ardhura më të mëdha	82.8

Ndonëse qytetarët kanë përgjithësisht një qëndrim negativ ndaj shtetit, duke e parë shtetin e së kaluarës komuniste si represiv dhe shtetin e periudhës së tanishme, post-komuniste, si parazit dhe të korruptuar, nga tabela e mëposhtme del se ekziston një konsens shumë i gjerë, praktikisht i plotë, në favor të ndërhyrjes së shtetit në ekonomi.

6. Sa duhet të ndërhyjë shteti në ekonominë e vendit?	%
1. Shumë	91.8
2. Pak	7.3
3. (Nuk e di)	0.9

Teksa nga përgjigjet e pyetjeve të mësipërme del se ekziston një konsens i gjerë në favor të zgjidhjeve të majta (gjithherë në kuptimin evropianoperëndimor të termit) për disa aspekte themelore të politikave sociale, të rishpërndarjes së të ardhurave dhe të ndërhyrjes së shtetit në ekonomi, nga tabela e mëposhtme, përkundrazi, del se, në lidhje me objektin e pyetjes, pra në lidhje me faktorin që përcakton gjendjen ekonomike të një personi, qytetarët shqiptarë anojnë qartazi nga ideologjia e së djathtës neoliberale. Siç dihet, ideologjia e majtë priret ta shpjegojë gjendjen e mirë ose të keqe ekonomike të një personi më së shumti si fryt të rastësisë, me çka përlligjet rishpërndarja e pasurisë në saje të tatimin progresiv (përligje që artikullohet edhe në organonin teorik të së majtës), ndërsa ideologjia e së djathtës neoliberale, mbizotëruese që nga fillimi i viteve 1980 në vendet anglosaksone dhe më pas e përhapur edhe në kontinentin evropian, e shpjegon gjendjen e mirë ose të keqe ekonomike të një personi si diçka që varet kryesisht nga ky person, përkatësisht nga zotësia ose pazotësia e tij. Kështu, në tabelën e mëposhtme shohim se shumica e të anketuarve anojnë nga shpjegimi ideologjik i së djathtës, ndërsa shpjegimi ideologjik i së majtës është ai që renditet i fundit si numër përgjigjesh. Gjithsesi, kjo pyetje ndryshon për nga natyra e saj me pyetjet paraardhëse: ato përfshihen tërësisht brenda sferës së politikave socio-ekonomike, ndërsa në pyetjen e tabelës së mëposhtme, ndonëse i adresohet gjendjes ekonomike të personit, konceptualisht kryefjala është personi, ose vështrimi i tij, e jo gjendja ekonomike si e tillë. Pra, kemi njeriun përballë kontekstit të tij shoqëror, në njëfarë kuptimi njeriun përballë botës, apo njeriun në botë, po edhe përballë vetes, me narrativën që i thotë vetes, dhe prandaj përgjigjja e kësaj pyetjeje ka një natyrë filozofike, pavarësisht sa i vetëdijshëm është i anketuari për këtë. Rrjedhimisht, nëse pyetjet e mësipërme i përkasin dimensionit socio-ekonomik të ndarjes ideologjike “e djathtë - e majtë” dhe janë të fokusuar në politika të caktuara shtetërore, pyetja e tabelës së mëposhtme i përket atij dimensionit që mund të quhet kulturor,

ose edhe subjektiv, në kuptimin e “botës jetësore” sipas Edmund Husserl-it apo të “domethënies subjektive” sipas Max Weber-it.

7. Cili është faktori më i rëndësishëm që përcakton gjendjen e mirë ose të keqe ekonomike të një personi? %

1. Zotësia/pazotësia individuale	53.2
2. Pasuria e trashëguar	16.5
3. Kontaktet që ka në pushtet	20.1
4. Favoret e ndërsjella në shoqëri	5.4
5. Rastësia/fati i mirë ose i keq	4.8
6. (Nuk e di)	0.2

Pyetja në tabelën e mëposhtme i përket qartazi dimensionit kulturor të ndarjes “e djathtë - e majtë”. Ideologjia e majtë prirret të jetë më liberale në aspektin familjar, sikurse edhe në zakone përgjithësisht, ndërsa ideologjia e djathtë prirret të jetë më tradicionaliste. Rezultatet e tabelës së mëposhtme dëshmojnë të njëjtën prirje në shoqërinë shqiptare sikurse ato të tabelës së mësipërme. Pra, përmbledhtazi për të gjitha tabelat e shqyrtuara deri tani, mund të themi se në Shqipëri ekziston një konsens shumë i gjerë në favor të atyre politikave socio-ekonomike që në Europën Perëndimore konsiderohen të majta, ndërsa në aspektin kulturor vërehet një anim nga ideologjia e së djathtës.

8. Në jetën familjare, si e konsideroni veten? %

1. Liberal/liberale	17.8
2. Tradicional/tradicionale	49.3
3. Diku në mes	32.7
4. (Nuk e di)	0.2

Në vijim, do të shohim korrelacionin e këtyre aspekteve të ndarjes ideologjike “e djathtë - e majtë” me vetidentifikimin ideologjik të të anketuarve (41% prej tyre e identifikuan veten si të majtë, 31.3% si të djathtë, 24.2% si të qendrës dhe 3.5% u përgjigjën “nuk e di”). Kështu, nga tabela e mëposhtme del se, pavarësisht nga vetidentifikimi ideologjik, ekziston një konsens shumë i gjerë në favor të politikave sociale ekspansive, në lidhje me shërbimin shëndetësor (pyetja 9/1), në lidhje me arsimin (pyetja 9/2) dhe në lidhje me përkrahjen e shtresave të varfra (pyetja 9/3), gjë që ishte e pritshme duke pasur parasysh tri tabelat e para të këtij studimi (shih më sipër tabelat 1, 2 dhe 3), ku përgjigjet në favor të politikave të tilla janë mbi 80%. E njëjta gjë mund të thuhet edhe në lidhje me tatimet (pyetja 9/5) dhe në lidhje me ndërhyrjen e shtetit në ekonomi (pyetja 9/6). Po kështu, edhe përgjigjet e pyetjes për strehimin (pyetja 9/4) tregojnë se vetidentifikimi ideologjik nuk ndikon në këtë drejtim. Nga ana tjetër, në lidhje me pyetjen për faktorin që ndikon më shumë në gjendjen ekonomike të personit (pyetja 9/7), kjo tabelë tregon se të anketuarit, pavarësisht nga

vetidentifikimi ideologjik, janë më të prirur të konsiderojnë si faktor të tillë zotësinë/pazotësinë individuale dhe se rastësia renditet e fundit për nga numri i përgjigjeve. Ndërkaq, vërejmë se të anketuarit që e identifikuan veten si të majtë janë më të prirur se të anketuarit e tjerë për ta shpjeguar gjendjen ekonomike të personit si fryt i zotësisë/pazotësisë individuale – çka është, në Perëndim, shpjegimi ideologjik i së djathtës. Në këtë aspekt, vërejmë, tek ata që e identifikuan veten si të majtë, një mospërputhje midis vetidentifikimit ideologjik dhe vlerave të ideologjisë përkatëse, madje një anim nga ideologjia e djathtë më të theksuar sesa të anketuarit e tjerë. Përgjigjet ndaj pyetjes pasuese (9/8), asaj për vetëperceptimin si liberal apo tradicional në jetën familjare, na japin një tablo krejt ndryshe: ndërsa të anketuarit, pavarësisht nga vetidentifikimi ideologjik, anuan më shumë nga tradicionalizmi – çka, në Perëndim, konsiderohet sistem vlerash i së djathtës, – një anim i tillë shfaqet më qartë midis atyre që e identifikuan veten si të djathtë. Pra, në këtë aspekt dhe në këtë kategori të anketuarish, kemi një përputhje më të madhe midis vetidentifikimit ideologjik dhe vlerave të ideologjisë përkatëse.

9. Të anketuarit sipas vetidentifikimit ideologjik:	Të majtë	Të djathtë	Të qendrës
<i>9/1. Si duhet të jetë shërbimi shëndetësor?</i>	%	%	%
1. Falas, mbuluar nga shteti për të gjithë pa dallim	82.7	86.0	81.0
2. Falas vetëm për ata me siguracion	15.4	12.0	14.8
3. Duhet favorizuar shërbimi privat, me pagesë	1.7	2.0	4.2
4. (Nuk e di)	0.2		
<i>9/2. Si duhet të jetë arsimiti?</i>	%	%	%
1. Falas, mbuluar nga shteti	84.5	85.8	82.6
2. Duhet favorizuar arsimiti privat, me pagesë	2.3	1.4	1.9
3. Sistem i përzier, me pagesë më të ulët se ai thjesht privat	13.0	12.8	15.0
4. (Nuk e di)	0.2		0.4
<i>9/3. Shtresat e varfra duhet të përkrahen kryesisht:</i>	%	%	%
1. Nga shteti	93.0	95.0	93.9
2. Nga shoqatat bamirëse	3.6	3.0	4.7
3. Nga rrethi familjar/shoqëror	3.0	2.0	1.4
4. (Nuk e di)	0.4		
<i>9/4. A mendoni se e drejta për banesë duhet të garantohet financiarisht nga shteti?</i>	%	%	%
1. Po	41.2	40.9	37.8
2. Jo, secili ta sigurojë vetë	57.1	53.8	60.4

3. (Nuk e di)	1.7	5.3	1.8
<i>9/5. Tatimi mbi të ardhurat duhet të jetë:</i>	%	%	%
1. Me përqindje të njëjtë për të gjithë	19.1	18.7	14.2
2. Me përqindje më të lartë për ata me të ardhura më të mëdha	80.9	81.3	85.8
<i>9/6. Sa duhet të ndërhyjë shteti në ekonominë e vendit?</i>	%	%	%
1. Shumë	92.1	91.6	90.8
2. Pak	6.9	6.9	8.7
3. (Nuk e di)	1.0	1.5	0.5
<i>9/7. Cili është faktori më i rëndësishëm që përcakton gjendjen e mirë ose të keqe ekonomike të një personi?</i>	%	%	%
1. Zotësia/pazotësia individuale	63.8	40.8	50.2
2. Pasuria e trashëguar	15.8	16.0	16.0
3. Kontaktet që ka në pushtet	11.8	30.7	23.0
4. Favoret e ndërsjella në shoqëri	4.3	4.9	7.4
5. Rastësia/fati i mirë ose i keq	3.9	7.5	3.4
6. (Nuk e di)	0.4		
<i>9/8. Në jetën familjare, si e konsideroni veten?</i>	%	%	%
1. Liberal/liberale	14.9	17.3	21.7
2. Tradicional/tradicionale	48.6	58.4	41.4
3. Diku në mes	36.6	24.0	36.4
4. (Nuk e di)		0.3	0.6

Tabela e mëposhtme tregon korrelacionin e aspekteve të ndarjes ideologjike “e djathtë - e majtë” me nivelin arsimor të të anketuarve (15.5% prej tyre janë me arsim të ulët, 54% me arsim të mesëm dhe 30.5% me arsim të lartë – universitar ose pasuniversitar). Nga përgjigjet e tyre, shohim të njëjtën dukuri sikurse në tabelën e mësipërme në lidhje me të gjitha aspektet e ndarjes ideologjike “e djathtë - e majtë”. Ndërkaq, vërejmë se, pothuaj në të gjitha aspektet e kësaj ndarjeje, të anketuarit me arsim të ulët janë më të prirur nga treguesit ideologjikë të së majtës dhe ata me arsim të lartë janë më të prirur nga treguesit ideologjikë të së djathtës. Bëjnë përjashtim përgjigjet që kanë të bëjnë me vetëperceptimin e të anketuarve si liberalë ose tradicionalë në jetën familjare (pyetja 10/8), ku shohim një dukuri të anasjelltë, si dhe përgjigjet në lidhje me ndihmën për të varfrit (pyetja 10/3) dhe në lidhje me ndërhyrjen e

shtetit në ekonomi (pyeجتa 10/6), në të cilat përqindjet e grupe sipas nivelit arsimor janë praktikisht të barabarta midis tyre.

10. Të anketuarit sipas nivelit të arsimit:	Të ulët	Të mesmë	Të lartë
<i>10/1. Si duhet të jetë shërbimi shëndetësor?</i>	%	%	%
1. Falas, mbuluar nga shteti për të gjithë pa dallim	93.7	87.0	71.5
2. Falas vetëm për ata me siguracion	4.7	10.6	25.2
3. Duhet favorizuar shërbimi privat, me pagesë	1.0	2.4	3.3
4. (Nuk e di)	0.6		
<i>10/2. Si duhet të jetë arsimit?</i>	%	%	%
1. Falas, mbuluar nga shteti	92.1	84.2	79.4
2. Duhet favorizuar arsimit privat, me pagesë	0.6	2.1	2.1
3. Sistem i përzier, me pagesë më të ulët se ai thjesht privat	6.7	13.3	18.5
4. (Nuk e di)	0.6	0.4	
<i>10/3. Shtresat e varfra duhet të përkrahen kryesisht:</i>	%	%	%
1. Nga shteti	93.5	93.4	94.4
2. Nga shoqatat bamirëse	3.6	3.9	3.4
3. Nga rrethi familjar/shoqëror	2.3	2.5	2.3
4. (Nuk e di)	0.6	0.1	
<i>10/4. A mendoni se e drejta për banesë duhet të garantohet financiarisht nga shteti?</i>	%	%	%
1. Po	49.9	40.7	34.7
2. Jo, secili ta sigurojë vetë	46.7	56.3	63.5
3. (Nuk e di)	3.4	3.1	1.8
<i>10/5. Tatimi mbi të ardhurat duhet të jetë:</i>	%	%	%
1. Me përqindje të njëjtë për të gjithë	14.1	16.6	20.0
2. Me përqindje më të lartë për ata me të ardhura më të mëdha	85.9	83.4	80.0
<i>10/6. Sa duhet të ndërhyjë shteti në ekonominë e vendit?</i>	%	%	%
1. Shumë	93.0	93.1	89.0

2. Pak	3.9	6.5	10.4
3. (Nuk e di)	3.1	0.5	0.7
<i>10/7. Cili është faktori më i rëndësishëm që përcakton gjendjen e mirë ose të keqe ekonomike të një personi?</i>	%	%	%
1. Zotësia/pazotësia individuale	45.5	50.2	62.2
2. Pasuria e trashëguar	19.0	16.7	14.8
3. Kontaktet që ka në pushtet	18.0	23.2	15.8
4. Favoret e ndërsjella në shoqëri	6.3	6.2	3.4
5. Rastësia/fati i mirë ose i keq	10.6	3.7	3.6
6. (Nuk e di)	0.6		0.3
<i>10/8. Në jetën familjare, si e konsideroni veten?</i>	%	%	%
1. Liberal/liberale	8.3	14.4	28.6
2. Tradicional/tradicionale	70.0	55.6	27.6
3. Diku në mes	20.8	29.9	43.8
4. (Nuk e di)	1.0	0.1	

Tabela e mëposhtme tregon korrelacionin e aspekteve të ndarjes ideologjike “e djathtë - e majtë” me nivelin e të ardhurave familjare (50.4% prej të anketuarve kanë të ardhura të ulëta familjare, deri në 750 Euro në muaj; 36.4% kanë të ardhura të një niveli të mesëm, 750-1500 Euro në muaj; 11.7% kanë të ardhura të larta, mbi 1500 Euro në muaj). Në këtë tabelë, shohim të njëjtat dukuri sikurse në tabelën e mësipërme, qoftë në konsensin midis grupeve përkatëse, qoftë në dallimet e prirjeve relative midis tyre. (Këtu, si dhe më poshtë kur të bëhet fjalë për nivelin e të ardhurave, duhet pasur parasysh se personat me të ardhura të larta, në mjaft raste anketimesh, priren t’i deklarojnë të ardhurat si më të ulëta nga sa i kanë realisht, gjë që përbën një dukuri të përhapur në shkallë globale).

11. Të anketuarit sipas nivelit të të ardhurave familjare:	Të ulëta	Të mesme	Të larta
<i>11/1. Si duhet të jetë shërbimi shëndetësor?</i>	%	%	%
1. Falas, mbuluar nga shteti për të gjithë pa dallim	90.9	76.4	73.2
2. Falas vetëm për ata me siguracion	7.6	19.7	24.8
3. Duhet favorizuar shërbimi privat, me pagesë	1.4	3.9	2.1
4. (Nuk e di)	0.2		
<i>11/2. Si duhet të jetë arsimi?</i>	%	%	%

1. Falas, mbuluar nga shteti	88.9	79.3	77.2
2. Duhet favorizuar arsimi privat, me pagesë	0.6	3.1	2.5
3. Sistem i përzier, me pagesë më të ulët se ai thjesht privat	10.3	17.1	20.3
4. (Nuk e di)	0.2	0.5	
<i>11/3. Shtresat e varfra duhet të përkrahen kryesisht:</i>	%	%	%
1. Nga shteti	93.9	92.8	96.9
2. Nga shoqatat bamirëse	4.1	3.7	0.8
3. Nga rrethi familjar/shoqëror	1.8	3.3	2.4
4. (Nuk e di)	0.2	0.2	
<i>11/4. A mendoni se e drejta për banesë duhet të garantohet financiarisht nga shteti?</i>	%	%	%
1. Po	49.3	33.5	26.8
2. Jo, secili ta sigurojë vetë	48.0	63.4	71.4
3. (Nuk e di)	2.7	3.0	1.8
<i>11/5. Tatimi mbi të ardhurat duhet të jetë:</i>	%	%	%
1. Me përqindje të njëjtë për të gjithë	14.3	19.0	20.1
2. Me përqindje më të lartë për ata me të ardhura më të mëdha	85.7	81.0	79.9
<i>11/6. Sa duhet të ndërhyjë shteti në ekonominë e vendit?</i>	%	%	%
1. Shumë	94.6	90.1	84.1
2. Pak	4.0	9.6	15.2
3. (Nuk e di)	1.4	0.4	0.8
<i>11/7. Cili është faktori më i rëndësishëm që përcakton gjendjen e mirë ose të keqe ekonomike të një personi?</i>	%	%	%
1. Zotësia/pazotësia individuale	48.8	56.4	61.5
2. Pasuria e trashëguar	16.2	15.9	21.2
3. Kontaktet që ka në pushtet	21.5	20.3	11.6
4. Favoret e ndërsjella në shoqëri	6.9	3.4	4.2

5. Rastësia/fati i mirë ose i keq	6.2	4.0	1.6
6. (Nuk e di)	0.4		
<i>11/8. Në jetën familjare, si e konsideroni veten?</i>	%	%	%
1. Liberal/liberale	14.0	21.2	22.2
2. Tradicional/tradicionale	61.0	39.3	33.9
3. Diku në mes	24.7	39.3	43.9
4. (Nuk e di)	0.3	0.2	0.4

Nga krahasimi i dy tabelave të mësipërme, vërejmë se përgjigjet e të anketuarve me nivel të ulët arsimor dhe të atyre me të ardhura të ulëta familjare kanë të njëjtën prirje në lidhje me aspektet e ndarjes ideologjike “e djathtë - e majtë”: konkretisht, janë më të prirur nga treguesit ideologjikë të së majtës sesa të anketuarit me nivel të lartë arsimor. Po kështu, përgjigjet e të anketuarve me nivel të lartë arsimor dhe të atyre me të ardhura të larta familjare kanë të njëjtën prirje për sa u përket aspekteve të ndarjes ideologjike “e djathtë - e majtë”: konkretisht, janë më të prirur nga treguesit ideologjikë të së djathtës sesa ata me nivel të ulët arsimor. Nga tabela e mëposhtme, del se ekziston një korrelacionin i fortë midis nivelit arsimor dhe të ardhurave familjare: niveli arsimor ndikon në gjendjen ekonomike të familjes përkatëse në mënyrë të atillë që, sa më i lartë niveli arsimor, aq më të larta të ardhurat familjare. Mund të thuhet gjithashtu se, anasjelltas, gjendja ekonomike e familjes mund të ndikojë në nivelin arsimor sipas oportuniteteve që krijon për të vazhduar shkollimin, por kjo lidhje e anasjelltë na duket më pak e qartë. Sidoqoftë, është e kuptueshme që shtresat më nevojtare për mbështetje sociale të jenë më të interesuara dhe, rrjedhimisht, më të prirura në favor të politikave sociale ekspansive, të cilat në Perëndim konsiderohen të majta.

12. Të anketuarit sipas nivelit të arsimit:	Të ulët	Të mesmë	Të lartë
<i>Sa janë të ardhurat mujore të familjes suaj?</i>	%	%	%
1. Të ardhura të ulëta	92.1	59.8	15.3
2. Të ardhura të mesme	7.1	35.8	54.2
3. Të ardhura të larta	0.9	4.4	30.5
<i><u>GJITHSEJ</u></i>	<i><u>100</u></i>	<i><u>100</u></i>	<i><u>100</u></i>

Tabela e mëposhtme tregon korrelacionin e aspekteve të ndarjes ideologjike “e djathtë - e majtë” me zonat ku banojnë të anketuarit, 65% e të cilëve në zona urbane (me pallate e vila) dhe 35% në zona rurale (me aktivitete ekonomike bujqësore e blegtorale). Nga përgjigjet e tyre, del se, përtej konsesit midis të anketuarve nga zonat urbane dhe atyre nga zonat rurale, këta të fundit, në disa aspekte (pyetja 13/1 dhe pyetja 13/4), anojnë më shumë sesa të parët nga politikatat sociale ekspansive. Ndërsa, në lidhje me vetëperceptimin si liberalë apo tradicionalë (pyetja 13/8), të anketuarit e zonave rurale anojnë nga kjo e fundit më shumë se të anketuarit e zonave urbane.

13. Të anketuarit sipas zonës së banimit:	Urbane	Rurale
<i>13/1. Si duhet të jetë shërbimi shëndetësor?</i>	%	%
1. Falas, mbuluar nga shteti për të gjithë pa dallim	80.8	88.1
2. Falas vetëm për ata me siguracion	16.0	10.7
3. Duhet favorizuar shërbimi privat, me pagesë	3.2	1.0
4. (Nuk e di)		0.3
<i>13/2. Si duhet të jetë arsimi?</i>	%	%
1. Falas, mbuluar nga shteti	84.7	82.5
2. Duhet favorizuar arsimi privat, me pagesë	1.9	1.9
3. Sistem i përzier, me pagesë më të ulët se ai thjesht privat	13.1	15.3
4. (Nuk e di)	0.3	0.3
<i>13/3. Shtresat e varfra duhet të përkrahen kryesisht:</i>	%	%
1. Nga shteti	94.0	93.3
2. Nga shoqatat bamirëse	3.8	3.5
3. Nga rrethi familjar/shoqëror	2.1	3.0
4. (Nuk e di)	0.1	0.3
<i>13/4. A mendoni se e drejta për banesë duhet të garantohet financiarisht nga shteti?</i>	%	%
1. Po	42.4	36.3
2. Jo, secili ta sigurojë vetë	55.3	60.2
3. (Nuk e di)	2.3	3.5
<i>13/5. Tatimi mbi të ardhurat duhet të jetë:</i>	%	%
1. Me përqindje të njëjtë për të gjithë	18.0	16.0
2. Me përqindje më të lartë për ata me të ardhura më të mëdha	82.1	84.1
<i>13/6. Sa duhet të ndërhyjë shteti në ekonominë e vendit?</i>	%	%
1. Shumë	92.1	91.1
2. Pak	7.1	7.6
3. (Nuk e di)	0.8	1.3

<i>13/7. Cili është faktori më i rëndësishëm që përcakton gjendjen e mirë ose të keqe ekonomike të një personi?</i>	%	%
1. Zotësia/pazotësia individuale	54.8	50.1
2. Pasuria e trashëguar	16.4	16.5
3. Kontaktet që ka në pushtet	20.7	19.0
4. Favoret e ndërsjella në shoqëri	4.6	6.8
5. Rastësia/fati i mirë ose i keq	3.3	7.4
6. (Nuk e di)	0.1	0.3
<i>13/8. Në jetën familjare, si e konsideroni veten?</i>	%	%
1. Liberal/liberale	18.9	15.7
2. Tradicional/tradicionale	44.9	57.4
3. Diku në mes	36.1	26.5
4. (Nuk e di)	0.1	0.4

Nga tabela e mëposhtme, që tregon korrelacionin e të ardhurave familjare dhe zonës së banimit, vërejmë se, në zonat rurale, të ardhurat janë përgjithësisht më të ulëta se në zonat urbane. Ky rezultat, së bashku me rezultatet e tabelës së mësipërme, që tregon korrelacionin e aspekteve të ndarjes ideologjike “e djathtë - e majtë” me zonat ku banojnë të anketuarit (tabela 13), e përforcon mendimin që kemi shprehur në komentin për tabelën 12, se shtresat më nevojtare janë më të prirura në favor të politikave sociale që konsiderohen të majta.

14. Të anketuarit sipas zonës së banimit	Urbane	Rurale
<i>Sa janë të ardhurat mujore të familjes suaj?</i>	%	%
1. Të ardhura të ulëta	45.5%	61.6%
2. Të ardhura të mesme	40.1%	31.2%
3. Të ardhura të larta	14.4%	7.2%
<i><u>GJITHSEJ</u></i>	<i><u>100%</u></i>	<i><u>100%</u></i>

Tabela e mëposhtme tregon korrelacionin e aspekteve të ndarjes ideologjike “e djathtë - e majtë” me moshën e të anketuarve (47.8% e të cilëve janë 18-49 vjeç dhe 52.2% janë 50 vjeç e sipër). Nga përgjigjet e pyetjeve të kësaj table, shohim se, në një sërë aspekteve të politikave sociale ekspansive (pyetja 15/1, pyetja 15/2, pyetja 15/5), grupi i parë është më pak i prirur në favor të tyre sesa grupi i dytë. Mendojmë se kjo ndodh ngaqë personat relativisht më të rinj në moshë janë më në gjendje për t’iu përshtatur një konteksti ku mbrojtja sociale është e mangët (veçanërisht për pensionistët).

15. Të anketuarit sipas moshës:	18-49	50+
<i>15/1. Si duhet të jetë shërbimi shëndetësor?</i>	%	%
1. Falas, mbuluar nga shteti për të gjithë pa dallim	80.3	86.3
2. Falas vetëm për ata me siguracion	16.4	11.8
3. Duhet favorizuar shërbimi privat, me pagesë	3.2	1.6
4. (Nuk e di)		0.2
<i>15/2. Si duhet të jetë arsimi?</i>	%	%
1. Falas, mbuluar nga shteti	80.5	87.5
2. Duhet favorizuar arsimi privat, me pagesë	2.8	1.0
3. Sistem i përzier, me pagesë më të ulët se ai thjesht privat	16.5	11.2
4. (Nuk e di)	0.2	0.3
<i>15/3. Shtresat e varfra duhet të përkrahen kryesisht:</i>	%	%
1. Nga shteti	94.6	92.9
2. Nga shoqatat bamirëse	3.0	4.5
3. Nga rrethi familjar/shoqëror	2.5	2.3
4. (Nuk e di)		0.3
<i>15/4. A mendoni se e drejta për banesë duhet të garantohet financiarisht nga shteti?</i>	%	%
1. Po	39.3	41.3
2. Jo, secili ta sigurojë vetë	59.4	54.6
3. (Nuk e di)	1.4	4.1
<i>15/5. Tatimi mbi të ardhurat duhet të jetë:</i>	%	%
1. Me përqindje të njëjtë për të gjithë	20.4	14.1
2. Me përqindje më të lartë për ata me të ardhura më të mëdha	79.6	85.9
<i>15/6. Sa duhet të ndërhyjë shteti në ekonominë e vendit?</i>	%	%
1. Shumë	90.7	92.9
2. Pak	9.1	5.4
3. (Nuk e di)	0.2	1.7

<i>15/7. Cili është faktori më i rëndësishëm që përcakton gjendjen e mirë ose të keqe ekonomike të një personi?</i>	%	%
1. Zotësia/pazotësia individuale	55.5	50.9
2. Pasuria e trashëguar	14.5	18.4
3. Kontaktet që ka në pushtet	20.1	20.2
4. Favoret e ndërsjella në shoqëri	6.7	4.0
5. Rastësia/fati i mirë ose i keq	3.2	6.3
6. (Nuk e di)	0.2	0.2
<i>15/8. Në jetën familjare, si e konsideroni veten?</i>	%	%
1. Liberal/liberale	27.8	7.7
2. Tradicional/tradicionale	33.3	65.4
3. Diku në mes	38.9	26.5
4. (Nuk e di)		0.5

Tabela e mëposhtme tregon korrelacionin e aspekteve të ndarjes ideologjike “e djathtë - e majtë” me gjininë e të anketuarve (49.9% janë gra, 50.1% janë burra). Nga përgjigjet e kësaj tablele, shohim se gjinia përgjithësisht nuk ndikon në lidhje me këto aspekte. Bën përjashtim aspekti i strehimit (pyetja 16/4), për të cilin gratë janë më të prirura se burrat në favor të garantimit të strehimit nga shteti si një e drejtë e qytetarit.

16. Të anketuarit sipas gjinisë:	Gra	Burra
<i>16/1. Si duhet të jetë shërbimi shëndetësor?</i>	%	%
1. Falas, mbuluar nga shteti për të gjithë pa dallim	83.6	83.1
2. Falas vetëm për ata me siguracion	13.3	15.0
3. Duhet favorizuar shërbimi privat, me pagesë	3.0	1.9
4. (Nuk e di)	0.2	
<i>16/2. Si duhet të jetë arsimiti?</i>	%	%
1. Falas, mbuluar nga shteti	84.4	83.5
2. Duhet favorizuar arsimiti privat, me pagesë	2.8	1.0
3. Sistem i përzier, me pagesë më të ulët se ai thjesht privat	12.4	15.3
4. (Nuk e di)	0.3	0.2

<i>16/3. Shtresat e varfra duhet të përkrahen kryesisht:</i>	%	%
1. Nga shteti	93.2	94.3
2. Nga shoqatat bamirëse	3.7	3.8
3. Nga rrethi familjar/shoqëror	3.0	1.8
4. (Nuk e di)	0.2	0.2
<i>16/4. A mendoni se e drejta për banesë duhet të garantohet financiarisht nga shteti?</i>	%	%
1. Po	43.4	37.2
2. Jo, secili ta sigurojë vetë	53.4	60.5
3. (Nuk e di)	3.2	2.3
<i>16/5. Tatimi mbi të ardhurat duhet të jetë:</i>	%	%
1. Me përqindje të njëjtë për të gjithë	16.3	18.2
2. Me përqindje më të lartë për ata me të ardhura më të mëdha	83.7	81.9
<i>16/6. Sa duhet të ndërhyjë shteti në ekonominë e vendit?</i>	%	%
1. Shumë	92.8	90.8
2. Pak	6.0	8.5
3. (Nuk e di)	1.2	0.7
<i>16/7. Cili është faktori më i rëndësishëm që përcakton gjendjen e mirë ose të keqe ekonomike të një personi?</i>	%	%
1. Zotësia/pazotësia individuale	51.4	54.9
2. Pasuria e trashëguar	18.7	14.3
3. Kontaktet që ka në pushtet	18.6	21.6
4. Favoret e ndërsjella në shoqëri	6.0	4.7
5. Rastësia/fati i mirë ose i keq	5.2	4.3
6. (Nuk e di)	0.2	0.2
<i>16/8. Në jetën familjare, si e konsideroni veten?</i>	%	%
1. Liberal/liberale	17.5	18.0

2. Tradicional/tradicionale	50.0	48.6
3. Diku në mes	32.0	33.4
4. (Nuk e di)	0.5	

Në tabelën e mëposhtme, te të anketuarit që e identifikojnë veten si të majtë vërehet një prirje shumë e theksuar e votimit për PS në zgjedhjet e fundit, sikurse te të anketuarit që e identifikojnë veten si të djathtë vërehet një prirje shumë e theksuar e votimit për PD. Prandaj, mund të themi se vetidentifikimi ideologjik i qytetarëve përputhet në një masë shumë të madhe me vetidentifikimet ideologjike përkatëse të dy partive kryesore të vendit.

17. Të anketuarit sipas vetidentifikimit ideologjik:	Të majtë	Të djathtë	Të qendrës
<i>Në zgjedhjet e majit 2025, për cilën parti votuat?</i>	%	%	%
1. PS	89.6	1.9	11.7
2. Koalicioni PD-LSI-etj.	0.5	73.9	8.0
3. Parti tjetër të vogël	2.8	5.5	30.6
4. Nuk votova fare	7.1	18.7	49.7
<u>GJITHSEJ</u>	<u>100</u>	<u>100</u>	<u>100</u>

Në tabelën e mëposhtme vërehet se, ndër të anketuarit nga familje që kanë qenë komuniste në kohën e diktaturës (21.1%), shumica dërrmuese u vetidentifikuan si të majtë dhe shumë rrallë u vetidentifikuan si të djathtë. Prirja e anasjelltë, ndonëse diçka më pak e theksuar, vërehet ndër të anketuarit nga familjeve të përndjekura politikisht ose të përziera (25.8% e të anketuarve).

18. Të anketuarit sipas statusit politik të familjes gjatë regjimit komunist:	Familje komuniste	E përndjekur ose e përzjerë	As njëra, as tjetra
<i>Nga pikëpamja ideologjike si e konsideroni veten?</i>	%	%	%
1. Të majtë	72.2	18.0	40.9
2. Të djathtë	11.3	57.5	25.3
3. Të qendrës	14.0	22.5	29.2
4. (Nuk e di)	2.5	2.1	4.6
<u>GJITHSEJ</u>	<u>100</u>	<u>100</u>	<u>100</u>

Në tabelën e mëposhtme vërehet se, ndër të anketuarit nga familje që kanë qenë komuniste në kohën e diktaturës, shumica dërrmuese kanë votuar për PS, parti e vetidentifikuar si e majtë, dhe fare pak prej tyre për PD, parti e vetidentifikuar si e djathtë. Prirja e anasjelltë, ndonëse, diçka më pak e theksuar, vërehet ndër të anketuarit nga familje të përndjekura politikisht ose të përziera. Kjo ngjashmëri me tabelën e mësipërme gjen shpjegim në rezultatet e tabelës 17, ku shohim se vetidentifikimi ideologjik i qytetarëve përputhet në një masë shumë të madhe me vetidentifikimet ideologjike përkatëse të dy partive kryesore të vendit.

19. Të anketuarit sipas statusit politik të familjes gjatë regjimit komunist:	Familje komuniste	E përndjekur ose e përzjerë	As njëra, as tjetra
<i>Në zgjedhjet e majit 2025, për cilën parti votuat?</i>	%	%	%
1. PS	72.6	18.0	39.2
2. Koalicioni PD-LSI-etj.	10.0	46.8	22.1
3. Parti tjetër të vogël	7.4	9.3	12.2
4. Nuk votova fare	10.1	25.9	26.5
<i><u>GJITHSEJ</u></i>	<i><u>100</u></i>	<i><u>100</u></i>	<i><u>100</u></i>

Në tabelën e mëposhtme vërehet se, ndër të anketuarit me të ardhura familjare të larta, ata që e identifikuan veten si të majtë janë – me një diferencë të konsiderueshme – më të shumtë se ata që e identifikuan veten si të djathtë.

20. Të anketuarit sipas të ardhurave familjare:	Të ulëta	Të mesme	Të larta
<i>Nga pikëpamja ideologjike si e konsideroni veten?</i>	%	%	%
1. Të majtë	42.0	39.5	41.8
2. Të djathtë	34.4	29.2	23.0
3. Të qendrës	20.3	28.3	28.9
4. (Nuk e di)	3.3	3.0	6.3
<i><u>GJITHSEJ</u></i>	<i><u>100</u></i>	<i><u>100</u></i>	<i><u>100</u></i>

Ngaqë, siç u pa në tabelën 17, vetidentifikimi ideologjik i qytetarëve përputhet në një masë shumë të madhe me vetidentifikimet ideologjike përkatëse të dy partive kryesore të vendit, në tabelën e mëposhtme, që tregon korrelacionin e mënyrës së votimit në zgjedhjet e fundit (40.2% PS, 26.4% PD dhe partitë aleate, 33.4% parti të tjera ose mospjesëmarrje) me nivelin e të ardhurave familjare, ndër të anketuarit me të ardhura të larta familjare vërehet e njëjta prirje sikurse në tabelën 20: pra, ata që votuan për PS, parti e vetidentifikuar si e majtë, janë më të shumtë se ata që votuan për PD, parti e vetidentifikuar si e djathtë. Madje, në tabelën e mëposhtme kjo prirje bëhet më e

theksuar. Megjithatë, korrelacioni i vetidentifikimit ideologjik dhe ai i mënyrës së votimit me prejardhjen familjare (tabelat 18 dhe 19 përkatësisht), është shumë më i fortë se ai me nivelin e të ardhurave.

21. Të anketuarit sipas të ardhurave familjare:	Të ulëta	Të mesme	Të larta
<i>Në zgjedhjet e majit 2025, për cilën parti votuat?</i>	%	%	%
1. PS	40.8	38.4	44.3
2. Koalicioni PD-LSI-etj.	28.6	25.3	20.0
3. Parti tjetër të vogël	8.8	10.7	15.3
4. Nuk votova fare	21.8	25.7	20.4
<u>GJITHSEJ</u>	<u>100</u>	<u>100</u>	<u>100</u>

Nga tabela e mëposhtme, del se, ndër të anketuarit që kanë votuar për PS-në në zgjedhjet e fundit, përqindja e punonjësve të sektorit shtetëror (shëndetësi, arsim, etj.) (20.3% e të anketuarve) është më e lartë sesa ajo e punonjësve të sektorit shtetëror ndër të anketuarit që votuan për PD-në (vetëm 10.1% e tyre). Duke qenë se rrogat në sektorin shtetëror janë përgjithësisht më të larta se në sektorin privat për punë të ngjashme, ky rezultat shpjegon pjesërisht prirjen e vërejtur në tabelën e mësipërme.

22. Të anketuarit sipas votimit të majit 2025:	PS	PD-ASHM	Votues të tjerë dhe mosvotues
<i>Çfarë pune bëni?</i>	%	%	%
1. Punëtor jo në bujqësi	12.5	15.1	18.8
2. Teknik/inxhinier	3.3	2.7	4.0
3. Menaxher	2.8	3.6	5.7
4. Shëndetësi/arsim	7.6	4.2	4.2
5. Punonjës tjetër shtetëror	12.7	5.9	3.1
6. Bujqësi/blegtori	4.5	4.5	4.9
7. I vetëpunësuar	19.0	22.6	25.6
8. Pensionist/invalid	30.3	31.7	19.2
9. Duke kërkuar punë	2.6	5.4	5.2
10. Në shtëpi, nuk po kërkoj punë	2.1	2.6	2.1
11. Student	2.1	1.7	6.8

12. Tjetër	0.4	0.0	0.4
<i>GJITHSEJ</i>	<i>100</i>	<i>100</i>	<i>100</i>

PËRMBLEDHJE

Siç e përmendëm në preambulën e këtij studimi, vetidentifikimi ideologjik “e djathtë - e majtë” në shoqërinë shqiptare përputhet me vetidentifikimin ideologjik të partive – PS e majtë, PD e djathtë. Kjo gjen shprehje qartazi në mënyrën e votimit. Në zgjedhjet legislative të majit 2025, ndër të anketuarit që e identifikuan veten si të majtë, 89.6% prej tyre kanë votuar për PS-në dhe vetëm 0.5% prej tyre për PD-në dhe partitë e vogla aleate të saj. Ndër të anketuarit që e identifikuan veten si të djathtë, 73.9% kanë votuar për PD-në dhe partitë e vogla aleate të saj dhe vetëm 1.9% prej tyre për PS-në. Por, siç mund të shihet nga tërësia e tabelave të këtij studimi, ky identitet ideologjik nuk përputhet aspak me ndarjen “e djathtë - majtë” në kuptimin që u jepet këtyre termave në Europën Perëndimore, e cila, siç thamë, është hapësira klasike e kësaj mënyre identifikimi në politikë.

Para së gjithash, duhet të theksojmë se, pavarësisht nga vetidentifikimi ideologjik i qytetarëve, ekziston një konsens shumë i gjerë (82%-94%, siç del nga përgjigjet e të anketuarve) në favor të politikave historikisht të majta europianoperëndimore për arsimin, shëndetësinë, tatimet, ndihmën sociale dhe ndërhyrjen e shtetit në ekonomi. Tri grupet e vetidentifikimit ideologjik, si të majtë, të djathtë, apo të qendrës, nuk dallohen prej njëri-tjetrit për nga nivelet e përkrahjes së politikave të tilla. Po kështu, ekziston një prirje transversale, pavarësisht nga vetidentifikimi ideologjik, në përgjigjet ndaj pyetjes për faktorin që ndikon më shumë në gjendjen ekonomike të një personi dhe ndaj pyetjes së vetëperceptimit si liberal apo tradicional në jetën familjare. Veçse është një prirje në kah të kundërt: për pyetjen e parë, më shumë se gjysma e të anketuarve mendojnë se faktori kryesor është zotësia/pazotësia individuale, ndërsa, për të dytën, pothuaj gjysma e konsiderojnë veten tradicionalë në jetën familjare dhe më pak se një e pesta e konsiderojnë veten liberalë. Në të dyja rastet, përgjigjet e tërësisë së të anketuarve, pavarësisht nga vetidentifikimi i tyre, anojnë nga ideologjia e djathtë në kuptimin europianoperëndimor të termit. Madje, në lidhje me të parën e këtyre dy pyetjeve, ata që e identifikuan veten si të djathtë janë më të prirur se të tjerët për të konsideruar si faktor të tillë rastësinë – çka është, në Perëndim, shpjegimi ideologjik i së majtës për gjendjen ekonomike të personave, me çka përlligjet rishpërndarja e të ardhurave – dhe janë më pak të prirur se të tjerët për ta konsideruar si faktor të tillë zotësinë/pazotësinë individuale – çka është, siç thamë, shpjegimi ideologjik i së djathtës neoliberale; ndërsa të anketuarit që e identifikuan veten si të majtë janë më të prirur se të anketuarit e tjerë për ta shpjeguar gjendjen ekonomike të personit pikërisht me këtë faktor, çka do të thotë se në këtë aspekt përkojnë me ideologjinë e djathtë më shumë se të anketuarit që e identifikuan veten si të djathtë. Gjithsesi, në lidhje me faktin që përgjigjet e këtyre dy pyetjeve kanë një prirje të kundërt me përgjigjet e pyetjeve të tjera që u referohen treguesve të ndarjes ideologjike “e djathtë - e majtë” në Europën Perëndimore, mendojmë se kjo ndodh ngaqë natyra e këtyre dy pyetjeve, siç e kemi shpjeguar në komentin për tabelën përkatëse, mund të quhet “kulturorë”, ndërsa të gjitha pyetjet e tjera që i referohen dallimit ideologjik janë të fokusuar në politika shtetërore të caktuara. Pra, mund të themi se, për nga treguesit ideologjikë “e djathtë - e majtë”, ekziston përgjithësisht një konsens i majtë në dimensionin socio-ekonomik

të kësaj ndarjeje dhe një prirje qartazi e djathtë në dimensionin kulturor të saj, pavarësisht nga vetidentifikimi ideologjik i qytetarëve.

Atëherë, çfarë e përcakton këtë vetidentifikim ideologjik? Në këtë kontekst, na duket interesant, nga pikëpamja e raportit midis ideologjisë dhe realitetit socio-ekonomik të qytetarëve shqiptarë, një rezultat që përbën të kundërtën e këtij raporti siç paraqitet në Perëndim: të anketuarit me të ardhura të larta familjare (mbi 1500 Euro në muaj) janë më të prirur ta identifikojnë veten si të majtë (41.8% e të anketuarve të këtij grupi, kundrejt 23% që e identifikuan veten si të djathtë nga ky grup) dhe po ashtu më të prirur të votojnë për PS-në (44.3%, kundrejt 20% që votuan për PD-në). Kjo shpjegohet pjesërisht me faktin se, ndër të anketuarit e punësuar në sektorin shtetëror, ku rrogat janë përgjithësisht më larta se në sektorin privat për punë të ngjashme, numri i atyre që votuan për PS-në (20.3% e të anketuarve) është më i madh se i atyre që votuan për PD-në (vetëm 10.1%), përpos që modeli i politikave socio-ekonomike të PS-së, jo më pak neoliberal se ai i PD-së, është i atillë që, në thelb, favorizon polarizimin.

Ndërkaq, pakrahasimisht më shumë se interesi ekonomik, ajo çka përcakton vetidentifikimin ideologjik të qytetarëve shqiptarë është prejardhja familjare. Ndër qytetarët me prejardhje nga familje komuniste, shumica dërrmuese e identifikojnë veten si të majtë (72.2% e të anketuarve, kundrejt 11.3% që e identifikuan veten si të djathtë) dhe votojnë për PS-në (72.6% e të anketuarve, kundrejt 10% që votuan për PD-në), ndërsa pjesa më e madhe e qytetarëve me prejardhje nga familje të përndjekura ose të përzierja nga pikëpamja e statusit politik nën diktaturën komuniste e identifikojnë veten si të djathtë (57.5% e të anketuarve, kundrejt 18% që e identifikojnë veten si të majtë) dhe votojnë për PD-në (46.8% e të anketuarve, kundrejt 18% që votuan për PS-në).

Pra, vetidentifikimi ideologjik i qytetarëve shqiptarë nuk ka të bëjë me treguesit e dallimit “e djathtë - e majtë” sipas kriteveve europianoperëndimore. Sikurse e pamë, në lidhje me të gjithë këta tregues, në shoqërinë shqiptare ekziston një transversalitet midis grupeve të vetidentifikimit ideologjik. Po kështu, nëse shikojmë përputhjen e këtij vetidentifikimi me mënyrën e votimit, ku 89.6% e atyre që e identifikuan veten si të majtë kanë votuar për PS-në dhe 73.9% e atyre që e identifikuan veten si të djathtë kanë votuar për PD-në dhe partitë e vogla aleate të saj, vërejmë edhe një të dhënë tjetër me interes: ndër të anketuarit që e identifikuan veten si të qendrës, shumica e atyre që morën pjesë në zgjedhje kanë votuar për partitë e reja. Kjo na duket shumë domethënëse: teksa ndër partitë e reja gjejmë të pranishme ideologjikisht edhe të majtën, edhe të djathtën, votimi për këto parti është një centrizëm sui generis: jo si shprehje e një ideologjie centriste, po si refuzim edhe ndaj PS-së, të identifikuar si të majtë, edhe ndaj PD-së, të identifikuar si të djathtë. Një mënyrë e tillë votimi, ku qendra paraqitet si mohim, si zbrazëti (çka e përforcon edhe e dhëna se pothuaj gjysma e të vetidentifikuarve si të qendrës nuk votuan fare), nxjerr në pah edhe më mirë zbrazëtinë e vetidentifikimit ideologjik. Nga kjo pikëpamje, Shqipëria ka mbetur aty ku ishte para tre dekadash e gjysmë, kur PS-ja, trashëgimtare e partisë komuniste, e quajti veten të majtë, ndërsa PD-ja ishte shfaqur si alternativë dhe si front i gjerë antikomunist. Në atë moment, njerëzit e lidhur me regjimin e vjetër dhe, rrjedhimisht, me trashëgimtarin e partisë komuniste, e identifikuan veten si të majtë, ndërsa ata që aspironin një ndryshim regjimi përkrahën më së shumti partinë kryesore të opozitës së atëhershme dhe e identifikuan veten kështu si të djathtë. Që nga ajo kohë, janë krijuar një mori partish të tjera, por të gjitha u atrofizuan shumë shpejt, ndonjëherë edhe qysh në embrion. Dhe, ndërsa PS-ja dhe PD-ja kanë pësuar ndryshime në këto tre dekada e gjysmë, inercia e mungesës së traditës demokratike dhe e patriarkalizmit politik vazhdon.